

KOMUNA VUSHTRRI

NPL "Përparimi" SH.A Vushtrri

Bazuar në nenin 17 shkronja "f" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 79 shkronja "e", "h", "i", "q", dhe "s" të Statutit të Komunës, si dhe nenin 12 të Marrëveshjes Nr.542/21, dt. 17.05.2021 për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë, lidhet ky:

ANEKS I DYTË - MARRËVESHJE

PËR KRYERJE TË SHËRBIMEVE KOMUNALE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Palët nënshkruese të kësaj Aneks Marrëveshje,

- Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga **z. Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna),

dhe
- NPL "Përparimi" SH.A Në Vushtrri, përfaqësuar nga **z. Fadil Bahtiri**, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes (në tekstin e mëtejme Ndërmarrja),

Neni 1.

Me këtë Aneks – Marrëveshje ndryshohet dhe plotësohet Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe NPL "Përparimi" SH.A Në Vushtrri Nr.542/21, dt. 17.05.2021, si në tekstin në vijim:

Pas nenit të 8 të marrëveshjes bazë shtohet nen i ri, 8 a) si në vijim:

1. Komuna e Vushtrrisë siguron materialin dhe mjetet higjienike të punës për pastrim të objekteve të institucioneve publike të përcaktuar në marrëveshjen bazë.
2. Komuna e Vushtrrisë me rastin e kryerjes së pagesave për shërbimet e kryera nga NPL "Përparimi" do të përfshijë edhe TVSH-në.

Neni 2

Pjesët tjera të marrëveshjes bazë mbesin të pa ndryshuara.

Neni 3

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.


Neni 4

Kjo Aneks Marrëveshje është përpiluar në tre ekzemplar në original - një për NPL "Përparimi" SH.A dhe dy për Komunën e Vushtrrisë.

Datë, 06.10 2021

NPL "Përparimi" SH.A


Fadil Bahtiri, Kryeshef Ekzekutiv



Komuna e Vushtrrisë


Xhafer Tahiri, Kryetar





NPL "Përparimi" SH.A, - VUSHTRRI

Për Kryetarin e Komunës Xhafer Tahiri

Lënda: Kërkesë

I nderuar Kryetar i Komunës Z. Tahiri shpresojë të jeni mirë dhe punët janë duke shkuar mbarë, si Kryeshef Ekzekutiv I NPL "Përparimi" SH.A, dua të ju njoftojë se aktualisht NPL "Përparimi" SH.A, bazuar në gjendjen financiare aktuale që e ka, e ka të pamundur ti mbulojë shpenzimet e TVSH-së si dhe materialin higjienikë për mirëmbajtje të institucioneve në kuadër të komunës të cilat mirëmbahen nga NPL "Përparimi" SH.A, bazuar në marrëveshjen me numër protokoli.14/21,data;17.05.2021.

I nderuari kryetar ju njoftojë se gjatë hartimit të marrëveshjesë me numër protokoli.14/21,data;17.05.2021 ka rrjedhur një gabim ku nuk është paraparë të paguhet vlera e TVSH-së si dhe mbulimi i shpenzimeve të materialeve higjienike nga Komuna si aksionare e vetme, deri në një kohë të caktuar kur NPL "Përparimi" SH.A krijon të hyra të qëndrueshme financiare.

Andaj bazuar në këtë gjendje aktuale financiare kërkojmë nga Komuna si aksionare e vetme që të marrë për bazë kërkesën e NPL "Përparimi" SH.A, për shpenzimet e TVSH-ë si dhe të na furnizojë me mjete higjienike sipas kontratës paraprake e cila është akoma në fuqi deri në muaj e pestë (Maj) 2022

Data; 30.09.2021

Kryeshef Ekzekutiv:

Fadil Bahtiri

